




BULETIN MUJOR


JANAR 2025



PËRMBAJTJA


- Organizohet Simulimi Red vs Blue Team në laboratorin fizik të AKSK
- Diskutime për Forcimin e Sigurisë Kibernetike: Takimi Bilateral me Këshillin Rajonal të Bashkëpunimit
- AKSK organizon Cyber Drill me studentët e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në UAMD Durrës
- Cyber Drill për Studentët e Universitetit të New York-ut
- Takim Ndërgjegjësues për Rëndësinë e Sigurisë Kibernetike Me Studentët e Kolegjit Universitar 'Qiriazi'

Organizohet Simulimi Red vs Blue Team në laboratorin e Sigurisë Kibernetike të AKSK



Në një mjedis simulimi, Red Team testoi dobësitë e sistemeve kritike, duke synuar ndikim maksimal në sistemet Scada/PLC të qyteteve përmes sulmeve të simuluar. Nga ana tjetër, Blue Team u angazhua në monitorimin, zbulimin dhe ndalimin e këtyre veprimeve në kohë reale.

Rezultatet e këtij simulimi kontribuojnë në identifikimin e hapësirave për përmirësim, forcimin e sigurisë së sistemeve kritike dhe uljen e ndikimit nga sulmet e mundshme kibernetike.



Diskutime për Forcimin e Sigurisë Kibernetike: Takimi Bilateral me Këshillin Rajonal të Bashkëpunimit

AKSK zhvilloi një takim bilateral me Këshillin Rajonal të Bashkëpunimit (RCC) lidhur me nevojat e vendit në fushën e sigurisë kibernetike. Përfaqësuesit e AKSK, AKSHI, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), Policisë së Shtetit prezantuan situatën aktuale të sigurisë kibernetike në vend si dhe adresuan nevojat në këtë drejtim.

Diskutimet u përqendruan edhe mbi krijimin e bazës rajonale të të dhënave për projektet e sigurisë kibernetike në Ballkanin Perëndimor. Ky takim ishte pjesë e një nisme të përbashkët të Komisionit European (KE), Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe Integrative Internal Security Governance (IISG), me qëllim koordinimin dhe forcimin e kapaciteteve kibernetike në rajon.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



@aksk.gov.al



+355 422 21 039



AKSK organizon Cyber Drill me studentët e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në UAMD Durrës

Ekspertë të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilluan një Cyber Drill me studentët e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, ku u simuluan skenarë realë të sulmeve kibernetike. Gjatë këtij aktiviteti, studentët u përfshinë në mënyrë praktike në analizë të kërcënimeve dhe zgjidhjen e incidenteve në kohë reale.

Këto trajnime jo vetëm që forcojnë kapacitetet teknike të të rinjve, por janë edhe një mundësi për të zbuluar talente në fushën e sigurisë kibernetike.


Cyber Drill për Studentët e Universitetit të New York-ut

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike organizoi një Cyber Drill me studentët e Universitetit të New York-ut në Tiranë. Ky ushtrim u fokusua në simulimin e situatave reale të sulmeve kibernetike, duke ndihmuar pjesëmarrësit të zhvillojnë aftësi të avancuara për identifikimin dhe menaxhimin e incidenteve.

Pjesë kyçe e trajnimit përfshinte:

- Analizën dhe reagimin ndaj kërcënimeve në kohë reale.
- Zhvillimin e strategjive të mbrojtjes së infrastrukturës digjitale.
- Vendimmarrje në presion.

Angazhimi i AKSK për të mbështetur edukimin dhe zhvillimin profesional të studentëve mbetet prioritet, duke investuar në ndërtimin e një ekosistemi të sigurt dhe të qëndrueshëm kibernetik.



Takim Ndërgjegjësues për Rëndësinë e Sigurisë Kibernetike Me Studentët e Kolegjit Universitar 'Qirazi'

Studentët e Kolegjit Universitar "Qirazi" u bënë pjesë e një takimi ndërgjegjësues mbi rëndësinë e sigurisë kibernetike në epokën digjitale. Gjatë takimit, u diskutuan tema si mbrojtja e informacionit personal, rreziqet e sulmeve kibernetike dhe masat praktike për t'u mbrojtur online.

Këto aktivitete janë pjesë e përpjekjeve të AKSK për të fuqizuar të rinjtë me njohuri dhe aftësi që i ndihmojnë të jenë të sigurt në një botë gjithnjë e më të digjitalizuar.

